



Titulli i projektit

Vlerësimi i Trashëgimisë Etno-Gastronomike. Agro-turizmi si model i zhvillimit në ZF të Shijakut

Tipi i projektit

Zhvillim ekonomik

Vendndodhja e projektit

ZF Shijak

Buxheti i paravlerësuar

62,000 Euro

Përshkrimi dhe analiza e problemit/eve

Një nga komponentët kryesorë me më shumë efikasitet dhe në modë sot është Agro-turizmi. Zona Funksionale e Shijakut është një ndër zonat që i zotëron të gjitha parakushtet për një zhvillim të këtij sektori. Burimet natyrore, njerëzore, tradita, atraksionet e ndryshme kulturore krijojnë shtratin e nevojshëm për këtë sektor. Kjo qajse e zhvillimit të turizmit do të ndikojë në mënyrë të drejtpërdrejtë në rritjen e mundësive për punësim në zonat rurale, si dhe do të vlerësojë më shumë gjithë trashëgiminë kulturore, historike dhe kulinare të zonës. E gjitha kjo është në sinergji edhe me dokumentet strategjike për zhvillimin e rajonit, të përgatitura në rang Qarku, porse gjithashtu reflektohet edhe në politikat e zhvillimit të ndërmarra në nivel qendror, sidomos për zonat rurale.


Qëllimi/et specifik të projektit

Objektivi i përgjithshëm i projektit është: "Rigjallërimi i një zhvillimi të qëndrueshëm socio-ekonomik në Zonën Funksionale të Shijakut, duke promovuar një model të ri të turizmit të integruar".

Objektivat specifikë të synuara nga projekti mund të listohen si më poshtë:

- Promovimi i Zonës Funksionale të Shijakut si alternativë e turizmit rural në Shqipëri;
- Krijimi i itinerareve të Agroturizmit.
- Përfshirja në hartat dhe guidat turistike në Shqipëri dhe më gjerë në rajon.
- Traditat Etno-Gastronomike të zonës, shërbimet dhe produktet e hartëzuara dhe të dizajnuara në një ofertë të re për rajonin dhe ZF të Shijakut;
- Standarti i produkteve dhe shërbimeve Etno-Gastronomike i përmirësuar;
- Zhvillim dhe promovim i itinerarit Etno-Gastronomik të Rajonit dhe ZF të Shijakut;
- Xxx% e popullsisë që jeton në këto zona e trajnuar për zhvillimin e aktiviteteve të agroturizmit;
- 3-4 NJQV të përfshira si përfituese të nismës.

Rezultatet e pritshme dhe treguesit



Aktivitetet e projektit

- Grumbullimi, hartëzimi i trashëgimisë së prekshe dhe të paprekshme të etno-gastronomisë;
- Zhvillimi i një koncepti të qëndrueshëm turistik;
- Zhvillimi i një Programi Ndërtimi Kapacitetesh, i cili t'i përgjigjet nevojave të identifikuara për grupet e synuara;
- Organizimi i një panairi promovues në zonën e projektit dhe më gjërë;
- Zhvillimi dhe shpërndarja e materialeve promovuese;
- Prodhimi dhe instalimi i infrastrukturës orientuese;
- Prezantimi zyrtar dhe në rrjete sociale.

Kohëzgjatja e projektit parashikohet të jetë afërsisht 18 muaj.

Maturimi i projektit

Projekti në fjalë është një projekt-ide, i cili është zhvilluar fillimisht në bazë të nevojave dhe mangësive të evidentuara në Zonën Funksionale të Shijakut, si dhe duke marrë në konsideratë potencialet e pazhvilluara të kësaj zone. Një model i tillë zhvillimi në zonat rurale, por jo vetëm, vlerësohet si ndër më të suksesshmit dhe për rrjedhojë, duke marrë në konsideratë çfarë u tha më lart, mendojmë se aplikimi i tij do të sjellë një model të ri zhvillimi në Zonën Funksionale.

Burimet e financimit dhe partnerët në zbatim

Për zbatimin e këtij projekti, mundësitë e financimit mund të jenë: fondet e BE përmes Programit IPA, bashkëpunimet dypalëshe me rajone të ndryshme evropiane, etj.. Për zhvillimin e suksesshëm të këtij projekti mendojmë se do të duhet të angazhohen organizma që kanë punuar direkt me këtë profil turizmi. Ata duhet të jenë në bashkëpunim të ngushtë me autoritetet lokale.

Kostot e projektit

| | |
|---|--------|
| Grumbullimi, hartëzimi i trashëgimisë së prekshe dhe të paprekshme të etno-gastronomisë; Zhvillimi i një koncepti të qëndrueshëm turistik | 12,000 |
| Zhvillimi i një Programi Ndërtimi Kapacitetesh, Organizimi i një panairi promovues në zonën e projektit dhe më gjërë | 28,000 |
| Prodhimi dhe instalimi i infrastrukturës orientuese; Zhvillimi dhe shpërndarja e materialeve promovuese | 22,000 |